



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Keshilli i Ministrave

U R D H E R

Nr. 164, date 20.10.2004

PER

**KRIJIMIN E FAQEVE TE INTERNETIT PER INSTITUCIONET E
AMDINISTRATES PUBLIKE DHE PERMBAJTJEN E TYRE**

Ne mbeshtetje te pikes 3, te nenit 102, te Kushtetutes dhe te ligjit nr. 8485, date 12.05.1999, "Kodi I procedurave administrative te Republikes se Shqiperise",

U R D H E R O J:

1. Ministrite dhe Institucionet, ne varesi te Keshillit te Ministrave apo te Kryeministrit, perfshire dhe prefektet, te krijojne, brenda nje periudhe 3-mujore nga hyrja ne fuqi e ketij urdheri, faqet e tyre ne internet.

2. Institucionet, ne varesi te Ministrave, qe realizojne sherbime per publikun, qe japin licenca, certifikata apo vertetime, te krijojne, brenda te njejtut afat faqet e tyre ne internet.
3. Institucionet e tjera, ne varesi te ministrave qe nuk perfshihen ne piken 2 te ketij urdhri, t'i perfshijne te dhenat baze, sipas percaktimeve te pikes 6 te ketij urdhri, ne faqen e internetit te ministries, nga e cila varen.
4. Faqet ekzistuese te njesive te ndryshme, brenda ministrive, te jene pjese e integruar e faqes se internetit te ministrise perkatese.
5. Faqja e internetit, per cdo ministri, te kete ne adresen e saj shkruarimin e emrteses zyrtare te institucionit, si dhe prapashtesen identifikuese: "gov.al".
6. Faqja e internetit duhet te permbaje ne menyre te detyrueshme:
 - a. Stemen e Republikes se Shqiperise dhe emrtesen zyrtare te institucionit;
 - b. Pjesen e programit te qeverise, qe i perket insitucionit;
 - c. Misionin dhe funksionet e ministrise, perfshire edhe ato te institucioneve ne varesi te saj;
 - ç. Dokumentat strategjike te miratuara, per fushen e veprimit dhe funksionet e institucionit;
 - d. Adresen e plote te institucionit;
 - dh. Numrin e telefonit, faksit dhe adresen e e-mail-it te kontaktimit me ministrin/titullarin, anetaret e organit drejtues, zevendesministrin, zevendestitullarin dhe sekretarin e Pergjithshem;
 - e. Te dhenat e hollesishme, perfshire CV-ne e Ministrit, titullarit dhe te zevendesministrit apo zevendestitullarit;

- ë. Te dhenat e perditesuara per veprimtarine publike te institucionit;
- f. Emrin, numrin e telefonit, te faksit dhe adresen e e-mailit e punonjesit/punonjesve te ngarkuar per informimin dhe kryerjen e sherbimeve per publikun;
- g. Emrat, numrin e telefonit, te faksit dhe adresen e e-mail-it te drejtuesve te njesive (drejtorive, deparatamenteve, seksioneve), brenda institucionit;
- gj. Skemen organizative te ministrise, perfshire edhe ate te institucioneve ne varesi te saj;
- h. Legjislacionin baze per organizimin, funksionimin dhe funksionet e institucionit perkates;
- i. Listen e hollesishme te sherbimeve qe ofron institucioni per publikun, si licencat, certifikatat, vertetimet ku te perfshihen edhe:
 - i. procedura dhe kushtetet e perfitimit te tyre;
 - ii. dokumentacioni i nevojshem dhe kostoja per realizimin e sherbimit;
 - iii. formulari i aplikimit per secilin nga sherbimet dhe udhezuesin e plotesimit te tij;
 - iv. afati i detyrueshem per te marre nje pergjigjen per sherbimin e kerkuar;
 - v. afati dhe organi, ku realizohet ankimi ne rast te refuzimit te pergjigjes apo te mosfrimit te sherbimit ne afatin e detyrueshem ligjor.
- k. Buxhetin e miratuar vjetor, te ndare sipas zerave kryesore te shpenzimeve per vitin dhe buxhetin faktik per vitin e kaluar.

- 7. Faqja e internetit te ministrise apo institucionit te jete edhe ne gjuhen angleze.
- 8. Ngarkohen te gjitha ministrite dhe institucionet e mesiperme per zbatimin e ketij urdheri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

K R Y E M I N I S T R I

F A T O S N A N O